Western Balkans Investment Framework WBIF PROJECTS

Connecting projects with investment funds




Azhurnim i studimit të fizibilitetit. ESIA dhe azhurnim i projektit të hollësishëm për ndërtimin e rrugës N9 Prishtinë - Pejë (SEETO Route 6 B), seksioni Kijevë –Klinë deri Zahaq (30KM)

# Plani i veprimit mjedisor dhe social (ESAP)

# (Draft)

Fascilitimi i projekteve infrastrukturore për Ballkanin Përëndimor

IPA 2011-WBIF-FPI3

WB11-KOS-TRA-01

Dhjetor 2016

IPF CONSORTIUM

# Evidenca e publikimit dhe rishikimeve

| Revidimi | Data | Autori | Kontrolluesi | Aprovuesi | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| A | 23/12/2016 | Ana Petrovska | Ralph Henderson | Gordon Lamond | Raport i studimit të para-fizibilitetit<br>Shkurt 2016 – Drafti për komentet |

Ky dokument lëshohet për palën e cila e ka porositur atë dhe vetëm për qëllime specifike lidhur me  projektin e titulluar më sipër. Dokumenti  nuk duhet të mbështetet  në ndonjë palë tjetër apo të përdoret për ndonjë qëllim tjetër.

Ne nuk pranojmë asnjë përgjegjësi për pasojat që rrjedhin nëse ndonjë palë tjetër mbështetet tek ky dokument apo nëse ai përdoret për ndonjë qëllim tjetër, apo nëse ka ndonjë gabim apo lëshim që është si pasojë e gabimeve apo lëshimeve në të dhënat që janë dhënë nga palë të tjera

Ky dokument përmban informacion konfidencial dhe që është subjekt i pronësisë intelektuale. Ai nuk duhet t'i tregohet palëve të tjerë pa pajtimin tonë apo të palës që e ka kontraktuar.

Mott MacDonald

## PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Faza e planifikimit të projektit** | | | | | | |
| 1.1. | **Menaxheri i kualifikuar mjedisor dhe social:**<br>Emërohet një menaxher i kualifikuar mjedisor dhe social për të marrë përgjegjësinë e përgjithshme për pajtueshmërinë me kriteret VNMS, kriteret për leje, PVMS, PAA, KBTR dhe BERZH në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale. | Të gjitha çështjet mjedisore dhe sociale dhe ndikimet në to janë adresuar në mënyrë të duhur;<br>Procesi i raportimit shkon mirë. | BERZH PR1 -PR10<br>Kërkesat ligjore vendore, Direktivat e BE-së dhe praktikat e mira | *Burimet:* Të brendshme<br>*Përgjegjësia:*MI | Menjëherë | Menaxheri i kualifikuar mjedisor dhe social është punësuar | Nuk është emëruar ende |
| 1.2. | **Raportet e gjendjes:**<br>Përgatiten dhe dorëzohen raportet te BERZH dhe BEI mbi gjendjen e artikujve të PVMS | Të gjitha çështjet mjedisore dhe sociale dhe ndikimet në to janë adresuar në mënyrë të duhur;<br>Procesi i raportimit shkon mirë. | BERZH PR1 -PR10<br>Kërkesat ligjore vendore, Direktivat e BE-së dhe praktikat e mira | *Burimet:* Të brendshme<br>*Përgjegjësia:*MI | Në secilën etapë kryesore të projektit apo pas përfundimit të aktiviteteve madhore nga PVMS | Raportet përgatiten dhe i dorëzohen BEI dhe BERZH | Raportet të dorëzohen pas aprovimit dhe shpalosjes nga PVMS |
| 1.3. | **Pëlqimet dhe lejet:**<br>Merren dhe mirëmbahen të gjitha pëlqimet dhe lejet e kërkuara nga autoritetet kompetente.<br>Një databazë do të krijohet për të gjitha pëlqimet dhe lejet. | Të gjitha çështjet mjedisore dhe sociale dhe ndikimet në to janë adresuar në mënyrë të duhur;<br>Procesi i lejeve shkon mirë. | BERZH PR1 -PR10<br>Kërkesat ligjore vendore plotësohen | *Burimet:* Të brendshme<br>*Përgjegjësia:*MI/Kontraktori | Gjatë gjitha fazave të projektit (konceptuale, preliminare dhe fazën e projektit detaj) | Pëlqimet dhe lejet janë marrë. Databaza e pëlqimeve dhe lejeve është krijuar. Raportimi tek BEI/BERZH | Raportet të dorëzohen pas aprovimit dhe shpalosjes |

**Comment [MJ1]:** Auditimi i Sigurisë rrugore siç parashihet me Udhëzimin për sigurinë rrugore-kjo tashmë është brenda IPF5.

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.4. | **Azhurnimi i dokumenteve:**<br>Azhurnimi i VNMS dhe dokumenteve relevante si NTS/PVMS/PAA/NTS/KBTR/dhe PVZH për të pasqyruar progresin e projektit dhe gjetjen e studimeve individuale të paraqitura në këtë PVMS. | Të gjitha çështjet mjedisore dhe sociale dhe ndikimet në to janë adresuar në mënyrë të duhur;<br>Procesi i lejeve shkon mirë. | BERZH PR1 -PR10<br>Kërkesat ligjore vendore, Direktivat e BE-së dhe praktikat e mira | *Burimet:* Të brendshme<br>*Përgjegjësia:*MI/FPI Projektuesi/ Kontraktori | Gjatë gjitha fazave të projektit (konceptuale, preliminare dhefazën e projektit detaj) | Dokumentet e azhurnuara dhe aprovuara nga BEI dhe BERZH<br>Raportimi te BEI/BERZH | Draftet finale për shpalosje janë përgatitur (VNMS, NTS, PVMS, PAA dhe KBTR). PAR nuk përgatitet në këtë etapë. |
| 1.5. | **Vlerësimi hidrogjeologjik dhe plan i lehtësimit të ndikimit:**<br>Kryhet një vlerësim detaj hidro-gjeologjik përgjatë vijës së propozuar të autostradës për të përcaktuar rrezikun e ndikimeve në kualitetin dhe rrjedhën e ujit tokësor (në veçanti puset e përdorura për furnizim individual) dhe zhvillohet dhe implementohet lehtësim i duhur për të adresuar rreziqet e identifikuara. | Parandalimi i ndotjes,<br>Minimizimi i rreziqeve shëndetësore | BERZH PR3<br>Kërkesat vendore | *Burimi:*<br>MI të brendshme, FPI projektuesi dhe kontraktori<br>*Përgjegjësia:*<br>MI / FPI Projektuesi / Kontraktori | Gjatë zhvillimit të projektit Preliminar dhe atij detaj | Plani i kompletuar i vlerësimit hidro-gjeologjik dhe i lehtësimit të ndikimit në ujërat tokësore.<br>Raportimi tek BERZH/BEI.<br>Raportimi në RVMS tek BERZH/BEI | Nuk aplikohet në këtë etapë (Faza e projektit preliminar) |
| 1.6. | **Projektimi i sistemit të kullimit të autostradës:**<br>Kulllimi do të vlerësohet dhe projektohet për qëndrueshmëri në pajtim më kërkesat ligjore vendore dhe të BE-së, duke marrë parasysh parimet dhe çfarëdo detyrimi të imponuar nga kërkesat e projektit: | Parandalimi i ndotjes,<br>Minimizimi i rreziqeve shëndetësore | BERZH PR3<br>Kërkesat vendore | *Burimi:*<br>MI të brendshme, FPI projektuesi dhe kontraktori<br>*Përgjegjësia:*<br>MI / FPI Projektuesi / Kontraktori | Gjatë zhvillimit të projektit Preliminar dhe atij detaj | Pojekti i kompletuar i sistemit të kullimit të autostradës.<br>Raportimi tek BERZH/BEI.<br>Raportimi në RVMS tek BERZH/BEI | Nuk aplikohet në këtë etapë (Faza e projektit preliminar dhe detaj) |

**Comment [MJ2]:** Çështja e ndikimit në bizneset përgjatë rrugës të adresohet. Kjo më së miri mund të futet tek azhurnimi i hulumtimit social/LARF/RAP???

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | •Uji sipërfaqësor largohet sa më shpejt që të jetë e mundur nga shiriti rrugor<br>•Asfalti dhe strukturat e lidhura tokësore kullohen me efikasitet<br>•Rrjedha e ujit në rrugë menaxhohet në burim aty ku është praktikisht e arsyeshme<br>•Rrjedha e ujit në rrugë menaxhohet në sipërfaqe aty ku është praktikisht e arsyeshme<br>•Sistemet janë me kosto efektive për operim dhe mirëmbajtje gjatë jetës së tyre të projektuar<br>•Projekti ka parasysh efektet e mundshme të ndryshimit klimatik siç është paraparë me politikat qeveritare (dhe ndryshimet në hapësirën e ngjeshur) mbi jetën e projektuar të sistemeve<br>•Sistemet minimizojnë përdorimin e energjisë në jetën e tyre të projektuar<br>•Efekti i rrjedhës së ujit në rrugë mbi cilësinë e trupave ujore të pranuara minimizohet<br>•Gjenerimi i mbeturinave gjatë ndërtimit dhe operimit minimizohet<br>•Gjithë uji që rrjedh nga sistemi | | | | | | |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ekzistues tokësor duhet të mbahet ndaras nga sistemi kullues i rrugës<br>• Rrjedha sipërfaqësore e ujit nga rrugët anësore të autoritetit lokal mund të merren në konsideratë aty ku nuk ka derdhje alternative adekuate, duke iu nënshtruar marrëveshjes me organizatën mbikëqyrëse<br>• Asetet kulluese duhet të projektohen, menaxhohen,operohen dhe mirëmbahen në pajtim me kontratën relevante të mirëmbajtjes dhe menaxhimit dhe kërkesave nga ky tender.<br>Projekti i kullimit duhet të certifikohet për përshtatshmëri me legjislacionin relevant vendor dhe punët duhet të specifikohen në pajtim me specifikacionet teknike për punët në autostrada. | | | | | | |
| 1.7. | **Hapësirat për hudhjen e materialeve tepricë:**<br>Vendet për hudhjen e mbeturinave do të përcaktohen në bazë të hulumtimeve gjeo-mekanike dhe studimeve ekologjike nga specialisti: lokacionet selektohen me qëllim | Të shmanget dhe reduktohet humbja e habitateve (Aneksi I habitatet). | BERZH PR6<br>Kërkesat vendore<br>Direktivat e BE-së | *Burime:* Burimet e brendshme të caktuara (MI&FPI Projektuesi) dhe ekologjisti.<br>*Përgjegjësia:* MI ta udhëzojë Projektuesin e FPI | Para projektit të detajuar dhe finalizimitë të dokumenteve të kontratës. | Hapësirat për hudhje të definuara dhe aprovuara nga autoritetet kompetente<br><br>Raporti i implementimit të | Nuk aplikohet në këtë fazë.<br>Hapësirat për hudhje të materialit tepricë nuk janë përcaktuar ende dhe pritet që pas |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | të shmangies së ndonjë ndikimi në habitatet e ndjeshme dhe rrjedhat ujore; dokumentacioni i nevojshëm do të përgatitet dhe dorëzohet tek autoritetet relevante. MMPH dhe komunat do t'i japin lejet për këto lokacione sipas dokumentacionit përkatës; informatat për dokumentet dhe hartat e aprovuara do t'i përcillen kontraktorit përmes dokumentacionit të kontratës. Dokumentacioni i kontratës të ndalojë hudhjen e materialit tepricë të nxjerrë nga hapësirat e ndjeshme. | | | | | përfshihet në RVMS për BERZH/BEI. | hulumtimeve gjeomekanike,këto lokacione të përcaktohen në etapën e projektit preliminar. |
| 1.8. | **Modelimi i bazës së zhurmës, vlerësimi i ndikimit dhe masat lehtësuese**:<br>• Sudimi i detajuar i zhurmës në autostradë do të kompletohet gjatë zhvillimit të projektit preliminar bashkë me modelimin e bazës së zhurmës përgjatë autostradës<br>• Vlerësimet e ndikimit dhe masat lehtësuese do të revidohen në VNMS të azhurnuar<br>• Projekt detaj i masave lehtësuese p.sh. barrierë zhurme (nëse nevojitet), | Parandalimi i ndotjes,<br>Minimizimi i rreziqeve shëndetësore | BERZH PR3<br>Kërkesat vendore | *Burimi:*<br>MI të brendshëm, FPI projektuesi dhe kontraktori<br>*Përgjegjësia:*<br>MI / FPI Projektuesi / Kontraktori | Gjatë zhvillimit të projektit preliminar dhe atij detaj | Modelimi i bazës së zhurmës kompletuar,vlerësimi i ndikimeve dhe masat lehtësuese në VNMS e azhurnuar. Masat e inkorporuara në projektin detaj.<br>Raporti për BERZH/BEI.<br>Raporti në RVMS për BERZH/BEI | Nuk aplikohet në këtë etapë (Faza e projektit preliminar dhe detaj) |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | • Zhvillohet plani i menaxhimit të trafikut të ndërtimit. | | | | | | |
| 1.9. | **Modelimi i kualitetit të ajrit, vlerësimet e ndikimeve dhe masat lehtësuese**:<br>Aktivitetet lidhur me projektimin:<br>• Do të ndërmerret një hulumtim mbi kualitetin e ajrit me qëllim të vlerësimit të kushteve bazë dhe identifikimit të receptorëve të ndjeshmërisë;<br>• Modelimi i kualitetit të ajrit do të kryhet për të vlerësuar efektet e projektit mbi receptorët e ndjeshmërisë dhe nivelin e ekspozimit të tyre<br>• Azhurnimi i masave lehtësuese të pritura në VNMS si për fazën e ndërtimit ashtu edhe operimit<br>Do të krijohen plane të veprimit nga kontraktuesi:<br>• Plani i menaxhimit të pluhurit<br>• Plani i minimizimit të emetimit të gazrave te djegura<br>• Plani i menaxhimit të trafikut të ndërtimit. | Parandalimi i ndotjes,<br>Minimizimi i rreziqeve shëndetësore | BERZH PR3<br>Kërkesat vendore | *Burimi:*<br>MI të brendshëm, FPI projektuesi dhe kontraktori<br>*Përgjegjësia:*<br>MI / FPI Projektuesi / Kontraktori | Gjatë zhvillimit të projektit preliminar dhe atij detaj | Modelimi i bazës së kualitetit të ajrit kompletuar,vlerësimi i ndikimeve dhe masat lehtësuese në VNMS azhurnuar. Masat e inkorporuara në projektin detaj.<br>Raporti për BERZH/BEI.<br>Raport në RVMS për BERZH/BEI | Nuk aplikohet në këtë etapë (Faza e projektit preliminar dhe detaj) |
| 1.10. | **Auditimi i sigurisë rrugore (ASRR):**<br>Të financohet nga BERZH, MI do | Reduktimi i rreziqeve nga aksidentet dhe siguri rrugore e | BERZH PR4<br>Kërkesat vendore | *Burimet:* Burimet e bashkëpunimit teknik të ofrohen nga BERZH | Fundi i fazës së projektit detaj (dhe | Raport i Auditimit të sigurisë Rrugore i dokumentuar. | Nuk aplikohet në këtë fazë (Faza e projektit detaj) |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | të punojë me BERZH për të emëruar një auditor të pavarur dhe kompetent për sigurinë rrugore për të kryer një auditim të sigurisë rrugore sipas Direktivës së BE 2008/906/EC mbi kryerjen e projektit final dhe të etapave kyçe siç shpjegohet në Direktivë.<br>Pas ASRR duhet të ketë një përfshirje obligative të përmirësimeve të ekonomikisht të zbatueshëm të sigurisë në projekt. Auditimi i sigurisë rrugore do të kryhet nga një auditor i certifikuar. Aty ku rekomandimet e auditorit nuk implementohen, duhet t'i konfirmohen Bankës arsyet për refuzimin e secilit rekomandim. | përmirësuar. | Direktivat e BE | *Përgjegjësia:* MI/Konsultanti për ASRR | ASRR tjera pasuese në etapat kyçe siç parashihet me Direktivën e BE 2008/96/EC). | Raport në RVMS për BERZH/BEI. | |
| 1.11. | **Regjistri i angazhimeve:**<br>**Krijimi i Regjistrit të angazhimeve** për të dokumentuar të gjitha masat lehtësuese për fazën e projektit, para-ndërtimit, ndërtimit dhe operimin të cituara në dokumentacionin e VNMS, PVMS, NTS, KBTR dhe PAA, dhe për të identifikuar si adresohet angazhimi, dhe cila palë (p.sh. MI, kontraktori, palët e treta etj.) është | Të gjitha çështjet mjedisore dhe sociale dhe ndikimet adresohen në mënyrë të duhur;<br>Procesi i Raportmit shkon mirë. | BERZH PR1<br>Vullnetare dhe praktikat më të mira | *Burimet:* Të brendshme<br>*Përgjegjësia:*MI/ Kontraktori / Inxhinieri | Pas shpalosjes së E&S dokuments. | Regjistri i angazhimeve i gatshëm.<br><br>Raport në Raportn Vjetor Mjedisor dhe Social (RVMS) te BERZH/BEI | Nuk pregatitet në këtë fazë të zhvillimmit të projektit. |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | përgjegjëse. Ky Regjistër duhet të mirëmbahet gjatë gjitha fazave të projektit. Ai duhet t'i ofrohet kontraktorit dhe inxhinierit | | | | | | |
| 1.12. | **Sistemi i menaxhimit mjedisor dhe social (SMMS):**<br>Themelohen dhe implementohen SMMS (system i menaxhimit të mjedisit /plane të monitormit të lehtësimeve) për implementim të duhur të projektit.<br>Në fazën e planifikimi të projektit e **Plani i Monitorimit të Lehtësimit Mjedisor dhe Social (PMLMS), duke përfshirë të gjitha planet e veçanta (p.sh. plani i kontrollit të erozionit, plani imenaxhimit të luhurit etj.),** përgatitet si kapitull i veçantë i VNMS. PMLMS i nënshtrohet revidimit dhe azhurnimit deri në aprovimin final të projektit detaj.<br>PMLMS do të përfshijë lehtësime për çështje specifike duke përfshirë; minimizimin e shqetësimit të habitateve natyrore, punën në kanale të lumenjve, parandalimin e ndotjes së rrjedhave ujore,kontrollin e pluhurit/zhurmës, marrëdhënieve në komunitet, aranzhimeve për | Të gjitha çështjet mjedisore dhe sociale dhe ndikimet adresohen në mënyrë të duhur;<br>Optimizimi i menaxhimit mjedisor përmes një sistemi formal;<br>Ofrohen burime për trajnim dhe monitorim të emetimeve dhe ndikimeve. | BERZH PR1<br>Kërkesat ligjore vendore, direktivat e BE dhe praktikat më të mira | *Burimet:*MI, të brendshme<br>*Përgjegjësia:*<br>Projektuesi FPI / Kontraktori do të përgatisë dhe azhurnojë PMLMS.<br>MI do të jetë përgjegjëse për implementimin e përgjithshëm të SMMS /PMLMS.<br>MI të krijojë Njësinë e implementimit të Projektit (NJIP)<br>BERZH/BEI të mbikqyrë. | SMMS të krijohen nga MI me mbështjetjen e projektuesit FPI.<br>PMLMS të përgatitet nga projektuesi FPI / Kontraktori.<br>PMLMS të aprovohet nga MI dhe autoritetet vendore si pjesë e procesit të aprovimit të VNMS.<br>BERZH/BEI të mbikqyrë. | PMLMS është dokumentuar.<br>NJIP themeluar.<br>Ofron azhurnim mbi implementimin në RVMS për BERZH/BEI. | Në këtë fazë të zhvillimit të projektit – projekti konceptual, përgatitet vetëm PMLMS në VNMS, i cili është bazë për zhvillimin e PMMSN and PMMSO. |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | qasje, pengesave, zonave tampon, hudhjes së mbeturinave, kufizimeve sezonale në punë në rajone specifike, rehabilitimi i tokës, procedurave të gjetjes së shanseve, përgatitjes së planit për emergjenca dhe reagim, kontrollit të erozionit, reagimit në derdhje, planeve të shëndetit dhe sigurisë, planit të menaxhimit të fuqisë punëtore, menaxhimit të materialeve të rrezikshme dhe masat për parandalimin e ekspozimit të komunitetit, aktivitetet monitoruese etj. Plani duhet të listojë përgjegjësitë specifike. | | | | | | |
| 1.13. | **Procedura për Menaxhimin e Ndryshimeve në Projekt (PMNP)**<br>Implementohet një Procedurë për menaxhimin e ndryshimeve në project e cila përfshin vlerësimet, dhe ku është relevante, zbutjen e ndikimeve mjedisore dhe sociale të ndryshimeve në projekt. PMNP do të përfshijë dispozita të duhura për shpalosjen për publikun të çështjeve materiale që lidhen me ndryshimet në projekt. | Të gjitha çështjet mjedisore dhe sociale dhe ndikimet adresohen në mënyrë të duhur. | BERZH PR1 – PR10<br>Kërkesat ligjore vendore, direktivat e BE dhe praktikat më të mira | *Burimet:*MI, Të brendshme<br>*Përgjegjësia:*<br>MI do të jetë përgjegjëse për implementimin e PMNP.<br>MI të themelojë NJIP. | PMNP të krijohet nga MI me mbështetjen e projektuesit të FPI. | PMNP është dokumentuar.<br>NJIP themeluar.<br>Ofron azhurnim mbi implementimin në RVMS për BERZH/BEI. | PMNP prashihet në Kapitullin 7 të VNMS. PMNP do të implementohet në secilën fazë të zhvillimit të projektit. |
| 1.14. | **Studimi socio** | Pajtueshmëri me | BERZH PR5, | *Burimet:* Burimet e | Para finalizimit | Rezultate të | Nuk aplikohet në |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **ekonomik/Regjistrimi i përgjithshëm:**<br>**Një studim socio-ekonomik / regjistrim i përgjithshëm** kërkohet për personat e prekur nga projekti (duke përfshirë fshatërat lokale që varen nga N9 për qasje) me qëllim të përgatitjes së PVZH. Diskutime duhet të bëhen me komunat për planifikimin e këtyre studimeve. Studimet duhet të caktohen që idealisht të ndodhin në kohë paralele apo të ngjashme si inventari i aseteve. Studimi do të ndihmojë në identifikimin dhe regjistrimin e personave që nuk kanë ndonjë kërkesë ligjore të njohur për tokën që e mbajnë apo shfrytëzojnë në rajonin e ndikuar.<br>Gjatë studimeve socio-ekonomike duhet të mblidhen informata për të konfirmuar se cilat fshatëra përdorin dhe/apo kanë në pronësi tokë,duke përfshirë edhe çdo tokë bujqësore të braktisur. Strategjia për këto studime duhet të sigurojë që të përfshihen edhe grupet ne disavantazh (d.m.th. nuk duhet të bazohen vetën në personat që vijnë nëpër takime) dhe po ashtu të përfshihet edhe shfrytëzimi | kompensimin e BERZH<br>Për zhvendosjen ekonomike dhe ndikimet në jetesë që lidhen me blerjen e tokës dhe kufizimet në qasje. | Kërkesat vendore | brendshme të caktuara, apo konsulentët<br>NJIP të përmbajë një konsulent social më përvojë<br>*Përgjegjësia:*MI/Konsulentët<br>. | të PVZH dhe para fazës së ndërtimit. | dokumentuara dhe të implementuara të studimit socio-ekonomik / regjistrimit të përgjithshëm..<br><br>Strategjia për studim/regjistrim i dorëzohet BERZH për revidim kur përgatitet.<br><br>Raport në RVMS për BERZH/BEI | këtë fazë, do të përgatitet në fazën e projektit detaj. |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | zakonor i tokës nga fshatëra të caktuara.<br>Studimi do të identifikojë në veçanti të gjitha shtëpitë e banimit që duhet të shkatërrohen, familjet që duhet të zhvendosen dhe të ndihmohen në ristaurimin e jetesës në kosto të plotë dhe t'u ofrojë atyre asistencë të llojeve tjera po ashtu. | | | | | | |
| 1.15. | **Përgatitja e kornizës së blerjes së tokës dhe restaurimit të jetesës (KBTR) dhe planit të veprimit për zhvendosje (PVZH):**<br>Zhvillimi i kornizës së blerjes së tokës dhe restaurimit të jetesës të projektit (KBTR), duke përfshirë konsultimet me palët e ndikuara sa i përket kompensimit për shpronësimin e tokës,humbjen e qasjes dhe restaurimin e jetesës në përputhje PAA.<br>Vlerësohet ndikimi në bizneset që ndodhen përgjatë rrugës ekzistuese N9.<br>Zhvillimi i **Planit të veprimit për zhvendosje (PVZH)** për të përmbushur kërkesat nga PR5, duke përdorur kornizën e blerjes së tokës dhe zhvendosjen (KBTR) | Përshtatshmëri me kërkesat e BERZH<br>Kompensimi për shpërnguljen ekonomike dhe ndikimet në jetesë që lidhen me blerjen e tokës, zhvendosjen dhe kufizimet në qasje. | BERZH PR5,<br>Kërkesat vendore | *Burimet:* Burimet e brendshme të MI dhe konsulentët.<br>Llogari përcjellëse për kompensimin për blerjen e tokës dhe koston e zhvendosjes fizike deri në rivendosjen përfundimtare dhe asistencë tjetër.<br>NJIP të angazhojë një ekspert social/ligjor me përvojë.<br>*Përgjegjësia:*MI/Konsulentët/ Institucione tjera relevante vendore për mirëqenie sociale etj. | Para fazës së ndërtimit (d.m.th. asnjë tokë nuk qaset për punë deri në pagesat e kompensimit të pranuara nga palët legjitime të autorizuara). | Dorëzohet KBTR dhe PVZH tek BERZH/BEI për rishkim dhe aprovim.<br>Dokumentohen KBTRdhe PVZH.<br>Raporte të menjëhershme kërkohen nga BERZH/BEI.<br>Raport i progresit RVMS për BERZH/BEI. | KBTR përgatitet dhe aprovohet nga Bankat për shpalosje. PVZH do të përgtitet dhe aprovohet në fazën e projektit detaj. |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementin të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | si bazë, si dhe duke përdorur informatat nga studimi socio-ekonomik dhe pasi të jenë mbajtur konsultimet me pronarët dhe shfrytëzuesit lokalë të tokave.<br>MI do të marrë parasysh dizajne fizibile alternative të Projektit për të shmangur apo minimizuar shpërnguljen fizike dhe/ose ekonomike, duke balancuar koston dhe përfitimin mjedisor, social dhe ekonomik. Aty ku është e pashmangshme, zhvendosja duhet minimizuar dhe masa të duhura duhet të merren për të lehtësuar ndikimet negative te personat e shpërngulur dhe komunitetet mikpritëse duhet të planifikohen dhe të implementohen me kujdes. Blerja e tokës lidhur me projektin dhe/ose kufizimet në shfrytëzimin e tokës shpesh çojnë drejt shpërnguljes fizike të njerëzve si dhe shpërnguljes së tyre ekonomike. | | | | | | |
| 1.16. | **Implementimi i kornizës së blerjes së tokës dhe restaurimit të jetesës (KBTR) dhe planit të veprimit për zhvendosje (PVZH):** | Përputhshmëri me kërkesat e BERZH<br>Kompensim për zhvendosje ekonomike dhe | BERZH PR5,<br>Kërkesat vendore | *Burimet:* Burimet e brendshme të MI dhe konsulentët.<br>Llogari përcjellëse për kompensimin për blerjen e | Para fazës së ndërtimit (d.m.th. asnjë tokë nuk qaset për punë deri | KBTR dhe PVZH janë implementuar.<br>Raporte të menjëhershme kërkohen nga | Nuk aplikohen në këtë fazë. |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Implementimi i kornizës së berjes së tokës dhe restaurimit të jetesës (KBTR), duke përfshirë konsultime me palët e ndikuara sa i përket kompensimit për shpronësimin e tokës, humbjes së qasjes dhe restaurimit të jetesës në përputhje me PAA.<br>Implementimi i një **Plani të veprimit për zhvendosje (PVZH)** për të përmbushur kërkesat e PR5, duke përfshirë konsultimet publike dhe individuale me pronarët dhe shfrytëzuesit lokalë të pronave dhe tokës.<br>MI do t'u ofrojë të gjithë personave të zhvendosur dhe komuniteteve kompensim për humbjen e aseteve dhe koston e zëvendësimit të plotë dhe asistencën tjetër. Kjo ka për qëllim të rivendosë dhe potencialisht të përmirësojë, standardin e tyre të jetesës dhe/ose mjetet e jetesës të personave të zhvendosur në nivele të para-zhvendosjes. Masat mund të bazohen në tokë, burime, rroga dhe/ose aktivitete biznesore. Standardet për kompensim do të jenë transparentedhe konsistente | ndikime në jetesën në lidhje me blerjen e tokës, zhvendosjen dhe kufizimet në qasje. | | tokës dhe koston e zhvendosjes fizike deri në rivendosjen përfundimtare dhe asistencë tjetër.<br>NJIP në MI do të menaxhojë implementimin e PVZH.<br>*Përgjegjësia:*MI/Konsulentët/ Institucione tjera relevante vendore për mirëqenie sociale etj. | në pagesat e kompensimit të pranuara nga palët legjitime të autorizuara).<br>PVZH do të implementohet para ditës së fllimit të kontratës. | BERZH/BEI.<br>Raport i progresit RVMS për BERZH/BEI | |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | brenda Projektit.<br>Kompensimi do të bëhet në përputhje me ligjet vendore dhe kërkesave të BERZH. | | | | | | |
| **2** | **Faza e prokurimit** | | | | | | |
| 2.1. | **Kërkesat për dokumentacion të tenderit:**<br>Dokumentacioni për tender do t'u referohet të gjitha PR (përfshirë shëndetin dhe sigurinë, politikat e BNj dhe tjera), për kërkesat e këtij PVMS dhe të gjeturave dhe rekomandimeve të VNMS. | Pajtueshmëri me BERZH, kërkesat vendore dhe të BE,<br>Praktikat më të mira në dispozicion. | BERZH PR1 deri PR10,<br>Kërkesat vendore, kërkesat e BE. | *Burimet:* Burimet e brendshme të caktuara, ose konsulentët<br>NJIP të përfshijë një ekspert me përvojë në përgatitjen e tenderit.<br>*Përgjegjësia:*MI/Konsulentët | Para finalizimit të PVZH dhe para fazëssë ndërtimit. | Dokumentacioni i tenderit i përgatitur dhe aprovuar nga BERZH/BEI. | Nuk aplikohet në këtë fazë, do të përgatitet pas aprovimit të projektit detaj. |
| **3** | **Faza e para-ndërtimit** | | | | | | |
| 3.1. | **Sistemi i Kontraktorit për Menaxhimin Mjedisor dhe Social (SKMMS):**<br>Pas emërimit dhe do të krijojë dhe të implementojë një **sistem të menaxhimit mjedisor dhe social** për ndërtimin e autostradës i cili duhet të përfshijë (por jo të kufizohet në):<br>• Plan i reviduar i menaxhimit dhe monitorimit ndërtimor mjedisor dhe social (duke përfsirë edhe planet e veçanta sipas nevojës). **Plani i menaxhimit dhe** | Të gjitha çështjet mjedisore dhe sociale dhe ndikimet adresohen në mënyrë të duhur;<br>Optimizimi i menaxhimit mjedisor përmes një sistemi formal;<br>Ofrohen burime për trajnim dhe monitorim të emetimeve dhe ndikimeve. | BERZH PR1<br>Kërkesat ligjore vendore, Direktivat e BE dhe praktikat e mira | *Burimet:*Kontraktori<br>*Përgjegjësia:*<br>Kontraktori do të jetë përgjegjës për implementimin e SKMMS.<br>MI të mbikqyrë. | SKMMS të krijohet nga kontraktori dhe të aprovohet nga inxhinieri, MI dhe BERZH/BEI. | SKMMS dokumentohet.<br>Ofrohen të dhënë të azhurnuara përimplementimin e RVMS tek BERZH/BEI. | Në këtë fazë të zhvillimit të projektit – projekti konceptual, vetëm PMLMS përgatitet në VNMS, i cili është bazë për zhvillimin e SKMMS. |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **monitorimit ndërtimor dhe social** (i cili duhet të përfshijë lehtësimet për çështjet specifike duke përfshirë; minimizimin e zhurmës në habitatet natyrore, punën në kanalet e lumenjve, parandalimin e ndotjes në rrjedhat e ujit, kontrollin e pluhurit/zhurmës, marrëdhëniet me komunitetin marrëveshjet për qasje, pengesat, zonat tampon, hudhjet e mbeturinave, kufizimet sezonale në punë në rajone specifike, rehabilitimi i tokës, procedura e gjetjes së shansit, përgatitja për emërgjencë dhe plani i reagimit, kontrolli i erozionit, reagimi në derdhje, plani shëndetësor dhe i sigurisë, plani i menaxhimit të fuqisë punëtore, menaxhimi i materialeve të rrezikshme dhe masat për parandalimin ekspozimit te komuniteti etj.). Plani duhet të listojë përgjegjësitë specifike. | | | | | | |
| 3.2. | **Plani i monitorimit para-ndërtimor:**<br><br>Planet monitoruese mjedisore dhe sociale të para-ndërtimit, ndërtimt dhe operimit të krijohen si pjesë e | Të gjitha çështjet mjedisore dhe sociale monitorohen në mënyrë të duhur; | BERZH PR1<br>Kërkesat ligjore vendore, Direktivat e | *Burimet:*<br>Kontraktori sipas kontratës (sipas BoQ dhe specifikacioneve teknike) vetëm për fazën e para- | Kontraktori do të përgatisë planet e monitorimit të fazës së para- | Ekzistojnë planet monitoruese të dokumentuara dhe azhurnuara. | Në këtë fazë të zhvillimit të projektit – projekti konceptual, vetëm plani monitorues |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | projektit SMMS (shih veprimin 1.10) dhe të përfshihen në ESMP, PMMSN & PMMSO (sipas relevancës).<br><br>Veprimet **monitoruese para-ndërtimore** duhet të përfshijnë (por jo të kufizohen) si më poshtë:<br><br>• Nivelet e kualitetit të zhurmës dhe ajrit (p.sh. përfshirë por pau kufizuar në $NO_x$, $PM_{10}$, $PM_{2.5}$) të maten te receptoërt përfaqësues përgjatë rrugës;<br>• Monitorimi sipas kërkesës dhe sipas KBTR;<br>• Kualiteti i ujit (turbullira dhe oksigjeni i tretur ) në lumin Drini i Bardhe në një pikë rreth 200 m poshtë rrjedhës ku planifikohen të bëhen punimet;<br>• Kualiteti i ujit në lumin Bistrica e Pejes, në pikën më të afërt të lumit ku planifikohen punimet e ndërtimit;<br>• Kualiteti i ujit i puseve individuale më të afërta që përdoren për furnizim me ujë të pijshëm që gjenden në rreshtin jugor.<br><br>MI do të fusë këto kritere para-ndërtimore në projektin preliminar/detaj dhe në | Procesi i para-ndërtimit dhe Raportmit shkon mirë.<br><br>Rezultatet e monitorimit shpalosen, publiku është mirë iinformuar. | BE dhe praktikat më të mira | ndërtimit.<br><br>*Përgjegjësia:*<br><br>Para-ndërtimi dhe ndërtimi: konraktori është përgjegjës për organizimin e monitorimit të fazës së para-ndërtimit dhe ndërtimit. Disa veprime mund të kontraktohen jashtë tek palët e treta (p.sh.konsulentët e monitorimit, ekologjistët, etj.)<br><br>Inxhinieri të aprovojë planet monitoruese dhe të mbikqyrë aktivitetet.<br><br>MI të mbikqyrë. | ndërtimit dhe ndërtimit para se të fillojë ndërtimi, e që do të përfshijë edhe monitorimin bazë të parametrave (p.sh. ajrit, zhurmës, ujit, etj.) për t'u kryer para fillimit të ndërtimit.<br><br>Plani monitorues do të aprovohet nga inxhinieri mbikqyrës NJIP/dhe MI<br><br>Monitorimmi të vazhdojë gjatë fazës së ndërtimit. | Të dhëna të azhurnuara për implementim i ofrohen RVMS për BERZH/BEI.<br><br>Shpalosen të dhëna të monitorimit për palët e interesuara. | përgatitet në VNMS, i cili është bazë për zhvillimin e PPMN, PMN dhe PMO. |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | dokumentacionin e tenderit me qëllim që dizajneri i FPI / kontraktori t'i implementojë sapo të angazhohet dizajneri/ kontraktori, por para se të fillojnë punët ndërtimore. | | | | | | |
| 3.3. | **Monitorimi i marrëdhënieve me komunitetin (MMK):**<br>CPMLMS & Plani i angazhimit të akterëve (PAA) për të përshkruar parametrat dhe proceset e monitorimit të marrëdhënieve në komunitet, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e çështjeve të ngritura nga komuniteti lokal. | Të gjitha çështjet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale janë adresuar në mënyrë të duhur. | BERZH PR1<br>Kërkesat ligjore vendore, Direktivat e BE dhe praktikat më të mira | *Burimet:*MI/Kontraktori/ Inxhinieri<br><br>*Pëgjegjësia:*<br>Kontraktori do të jetë përgjegjës për implementimin e MMK.<br>Inxhinieri dhe MI të mbikëqyrin. | Menaxhimi i çështjeve të ngritura nga komuniteti. | MMK është dokumentuar.<br><br>Ofron të dhëna të azhurnuara mbi implementimin RVMS për BERZH/BEI. | MMK të krijohet para fillimit të ndërtimit. |
| 3.4. | **Shëndeti professional dhe siguria:**<br>Kontraktori do të themelojë një plan të shëndetit dhe sigurisë si pjesë e një sistemi të menaxhimit SHPS në përputhje me SHPSAS 18001 dhe udhëzimeve të përgjithshme EHS (2007) të KNF. Kushtet kontraktuale janë për t'u sigururar që të gjithë nënkontraktorët po ashtu do të ndjekin planin e shëndetit dhe sigurisë dhe sistemin e menaxhimit SHPS. | Performancë e përmirësuar e shëndetit dhe sigurisë dhe ambient i sigurt pune për fuqinë punëtore. | BERZH PR4<br>Kërkesat vendore<br>Praktikat më të mira | *Burimet:* Menaxheri i caktuar i MSHSS/SHPS<br><br>*Përgjegjësia:* Kontraktori i mbykëqyrur nga inxhinieri | Plani duhet të aprovohet para fillimit të ndërtimit.<br><br>Implementohet gjatë fazës së ndërtimit. | Plan i shëndetit dhe sigurisë i implementuar – statistika dhe të dhëna të vazhdueshme për siguri.<br><br>Ofron të dhëna të azhurnuara mbi implementimin RVMS për BERZH/BEI. | Nuk aplikohet në këtë fazë |

| Nr. | Veprimi | Rreziqet (Detyrimet/Përfitimet) mjedisore dhe sociale | Kriteret (Legjislative, BERZH PR, Praktikat më të mira) | Burimet, nevojat për investime, Përgjegjësia | Orari | Targeti dhe vleësimi i kritereve për implementim të suksesshëm | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.5. | **Politikat e BNJ:**<br>Politikat e HR duhet të përgatiten dhe implementohen nga kontraktori: këto përfshijnë dispozitat për ndalimin e përdorimit të punës së fëmijëve dhe punës së detyruar,dhe do të përfshijnë  të drejtat për punëtorët jo-nëpunës (sipas konventave të ONP dhe kërkesave të BERZH). | Menaxhim efektiv dhe i përmirësuar i HR dhe fuqisë punëtore.<br><br>Marrëdhënie e përmirësuar mes punëdhënësit dhe punëmarrësit<br>Përfitime ekonomike lokale | BERZH PR2<br>Kërkesat vendoredhe praktikat më të mira | *Burimet:*<br>Burimet e BNJ; Objektet shëndetësore (apo marrëveshjet për qasje të punëtorëve nëkëto objekte)<br><br>*Përgjegjësia:* Kontraktori | Fillimi me ndërtim | Politika të BNJ dhe Mekanizma për ankesë janë dokumentuar dhe implementuar.<br>Raporte të përmbushjes/auditit<br>Angazhime me komunat dhe ofruesit e shërbimeve mjekësore të regjistruara lokalisht.<br>Raport në RVMS për BERZH/BEI | Nuk aplikohet në këtë fazë |
